

RELACION ARGUMENTIMI
Objekti: SISTEMIM I ZONES SE FERMES
LAGJA NR. 1 POGRADEC

I. TE DHENA TE PERGJITSHME

Bloku objekt sistemimi ndodhet në pjesen juglindore te qytetit dhe kufizohet me :

Në veri ---- rruga “Korces”

Në jug ----- Rruga “Industriale”

Në perendim-----“Zona ish industriale dhe ish parku”

Ne Lindje ----- rruga “Unaze”

Rjeti rrugor brenda lagjes ka nje shtrirje vertikale me rrugen “Korces” dhe “Unaze” me degezime rrugesh brenda bllokut.

II. GJENDJA EKZISTUESE

a) Te dhena demografike.

Kjo lagje eshte nje nga lagjet e reja te qytetit te krijuara pas viteve 1990 me banesa 2-4 kate kryesisht individuale me një numer prej rreth 1000 banoresh. Kufizohet ne pjesen veriore me nje nga akset kryesore te qytetit sic eshte rruga e Korces ne lindje rruga unaze, dhe ne jug me zonen e industriale e qytetit .

Rruget e lagjes sherbejne si lidhje edhe për levizjen e banoreve drejt qendres dhe pjeseve te tjera ne qytetit.

b) Te dhena për infrastrukturën.

Rjeti rrugor ekzistues shtrihet gjate gjithë siperfaqes se lagjes duke e ndare ate në disa pjese dhe shume degezime . Rruget jane te paasfaltuara, te pa trajtuara, ndonjehere teresisht te demtuara me gropezime te theksuara në gjithë siperfaqet dhe ndikojne negativisht si ne aspektin teknik dhe ate mjedisor

Rjeti i kanalizimete u.z eshte trajtuar ne rrugen me drejtim pingul me rrugen e “Korces” segmenti “a” te emertuar ne projekt. Ky rjet kanalizimesh eshte trajtuar kryesisht ne segmentet e rrugeve ne drejtim pingul me rrugen e “Korces” si pjese e projektit te kanalizimeve te U.Z te qytetit me te gjitha elementet perberes te tij.

Mungon krejtesisht rjeti i kanalizimeve te ujrave siperfaqesore, rrjedhja e pakontrolluar e te cilave ne rastet e reshjeve ndikojne ne ndotjen e qytetit.

Per te gjitha keto, lind e domosdoshme nderhyrja me fonde publike per zbatimin e projekteve te sistemimit ne kete zone e cila eshte e perfshire ne objektivat e programit te parashikuar ne prioritetet e qeverisjes vendore per te beret te mundur qe edhe ne kete pjese te zones se banuar te krijohen kushtet per rritjen e cilesise se jetes, permiresimin e ambjentit, pejsazhit etj.

III. PROJEKTI I SISTEMIMIT SYNON:

Per shkak te situates ekzistuese te pershkruar me siper si edhe per problemet e lehtesimit te levizjes se njerezve e mjeteve, lind e domosdoshme nderhyrja me fonde publike per zbatimin e projekteve te sistemimit ne kete zone e cila eshte e perfshire ne objektivat e programit te parashikuar ne prioritetet e qeverisjes vendore per te bere te mundur:

Krijimin e kushteve e parametrave per nje permiresim te kesaj zone ne drejtim te:

- Permiresimit te cilesise se jeteses
- Permiresimit te ambjentit e pejsazhit.
- Permiresimit te qarkullimit te mjeteve te transportit dhe parkimet
- Lehtesimin e levizjes se njerezve .

IV. TE DHENA SPECIFIKE

- Numuri i rrugeve qe trajtohen jane 3 segmente kryesore dhe rreth 37segmente te tjera qe lidhen me ato.
- Gjeresia e trupit te rrugeve varion nga 3 deri 5 m
- Siperfaqe e pergjithshme rruge e trotuare eshte **16987** m²
- Siperfaqe e shtreses me pllaka granili me boje eshte 1202 m²
- kanalizimi i ujrave te bardha L = 4060 ml.
- Trajtimi i ndricimit realizohet në akset kryesore me ndricim te larte me kantelabra h= 7 ne seg. "a", dhe h=5m ne segmentet e tjera.
- Sistemi i ndricimit eshte i kompletuar me sistemin e komandimit dhe mbrojtjes së rjetit.

Per realizimin e projektit me zerat të mesiperm nevojitet nje fond prej **123740949** leke

Investimi i kerkuar pervecse do të beje të mundur realizimin e objektit me gjithë elementet e tij , dote beje të mundur sistemimin ne nje bllok banimi me parametra bashkekohore dhe permiresim të kushteve të jeteses dhe të ambjentit ne teresi .

Hartoi

**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT
SEKTORI I PROJEKTEVE TË INFRASTRUKTURES URBANE**

Ing.Majlinda Kuqo

ark.Veselina Gusho

